



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 693/1 prot.

Tiranë më 19.04.2021

Lënda: Kërkesë për bllokimin e faqe të internetit <https://adfrehasdghf.web.app/> dhe www.patronazhisti.com.

AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Tiranë

Në vijim të shkresës sonë Nr. 693 Prot., datë 16.04.2021, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ju informon se faqja e internetit <https://adfrehasdghf.web.app/> bart të njëjtën problematikë serioze, sa i përket cenimit eventual të të dhënave personale të qytetarëve, ashtu si faqja e internetit www.patronazhisti.com.

Të dyja këto faqe interneti përmbajnë një volum të jashtëzakonshëm të dhënash personale, aksesit në të cilat mundësohet në kundërshtim me, ndër të tjera, nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Për këtë arsye, nisur edhe nga volumi jashtëzakonisht i madh i të dhënave personale, që përmbajnë këto baza të dhënash të aksesueshme përmes faqeve të internetit <https://adfrehasdghf.web.app/> dhe www.patronazhisti.com, vlerësojmë emergjente ndërhyrjen tuaj të shpejtë për parandalimin e përhapjes së mëtejshme të të dhënave personale që gjenden në këto baza të dhënash.

Rrjedhimisht, bazuar në germën “b” të pikës 1 dhe pikën 2/1 të nenit 30 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kërkojmë bashkëpunimin dhe reagimin tuaj institucional dhe ligjor në lidhje me si vijon:

- (i) Bllokimin e menjëhershëm, nga ana e AKEP, të faqeve të internetit <https://adfrehasdghf.web.app/> dhe www.patronazhisti.com, si dhe çdo faqeje dhe/ose lidhjeje tjetër të aksesueshme përmes tyre, apo nga të cilat këto dy faqe interneti mund të aksesohen; dhe

- (ii) Ndërmarrjen, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e hapave të nevojshme proceduralë-ligjorë ndaj subjekteve që zotërojnë dhe/ose posedojnë faqet e internetit <https://adfrehasdghf.web.app/> dhe www.patronazhisti.com.

Lutemi të na informoni në lidhje me hapat e ndërmarra sipas pikave (i) dhe (ii) më sipër.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

